

KONKLuzionet e ARKEP

RIPËRTËRITJA E AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE PER TË DREJTËN E SHFRYTËZIMIT TË KAPACITETEVE FREKUENCORE NË BREZET 900 dhe 1800 MHz PER OPERATORËT “TELEKOMI I KOSOVËS SH.A” DHE “IPKO TELECOMMUNICATION LLC”

01 Korrik, 2019

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Korniza Rregullatore.....	4
3. Resurset frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz.....	7
3.1 Kapacitetet ekzistuese frekuencore në shfrytëzim nga Operatori Telekom i Kosovës Sh. A	8
3.2 Kapacitetet ekzistuese frekuencore në shfrytëzim nga IPKO Telecommunications LLC.....	9
4. Metodologjia vlerësimit të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz.....	9
5. Mënyra e dhënies bazuar në objektivat rregullatore.....	13
6. Përcaktimi i çmimit “One-off” për brezet 900 dhe 1800 MHz	14
7. Qëndrimet e ARKEP-it në procesin e ripërtëritjes së Autorizimeve individuale të resurseve frekuencore ne brezet 900 MHz dhe 1800 MHz ne shfrytëzim nga Operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO.....	18

1. Hyrje

Bordi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje; ARKEP ose Autoriteti*) mbështetur në dispozitat e Ligjit të Komunikimeve Elektronike (*tutje; LKE ose Ligji*), Rregullores Nr. 22 për “Dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave”, Planit Kombëtar të Radio frekuencave, Raportit nr.25 të ERC-CEPT (*The European Table of Frequency Allocations And Applications In The Frequency Range 8.3 kHz to 3000 GHz*), i cili ka përcaktuar se brezet 900 MHz dhe 1800 MHz janë të destinuar për shfrytëzim primar për shërbimet GSM dhe IMT duke përfshirë IMT-2000 dhe IMT-Avancuar si dhe teknologjive të avancuara si LTE (4 G) dhe IoT.

Me Vendimin Nr. 1388 (Ref. ARKEP Nr. Prot. 056/B/19), ARKEP ka miratuar fillimin e procesit të konsultimit publik të dokumentit me palët e interesit lidhur me ripërtëritjen e autorizimeve individuale me qëllim **vazhdimin e periudhës së vlefshmërisë për të drejtën e shfrytëzimit** të kapaciteteve frekuencore në brezin 900 MHz (880- 915 & 935- 960 MHz) dhe 1800 MHz (1710 - 1785 & 1805 - 1880 MHz) për operatorët Telekom i Kosovës Sh.A. dhe IPKO Telecommunications LLC.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti ARKEP ka përfshirë dhe ka marrë në konsiderim zbatimin objektivave rregullatore (Ref. pika 6 e këtij dok.) si dhe Kornizës Rregullatore të BE (referuar PIKES 2 të këtij dokumenti) ku precizohet edhe çështja e ripërtëritja e të drejtave individuale të shfrytëzimit të resurseve frekuencore, si dhe:

- Përmbushjen e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara sipas politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike;
- Nxitjen e investimeve efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një kualitet më të lartë të produkteve të tyre.
- Plotësimin të kërkesave të ndërmarrësve/operatorëve për resurse frekuencore duke ofruar fleksibilitet, ndarja dhe efikasiteti në shfrytëzimin e resurseve frekuencore;
- Nxitjen e një konkurrence sa më efikase në tregun e komunikimeve elektronike; si dhe
- E drejta e shfrytëzimit të resurseve frekuencore mbi bazën e legjislacionit në fuqi, përfshirë, rregullat për dhënien, transferimin, rinovimin, modifikimin dhe tërheqjen e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve frekuencore, në mënyrë që të garantohet siguria, konsistenca dhe para shikueshmëria rregullatore.

Qëllimi i këtij dokumenti është përfshirja e palëve të interesit në procesin e ripërtëritjes së autorizimeve individuale për vazhdimin e shfrytëzimit të resurseve ekzistuese frekuencore në brezin 900 dhe 1800 MHz për operatorët e telefonisë mobile në nivel nacional që njëherit nënkupton vazhdimin e ofrimit të shërbimeve brezgjëra - IMT në tërë territorin e vendit nga Operatorët **Telekom i Kosovës Sh.A dhe IPKO Telecommunication LLC**.

Ndër çështjet e përfshira në këtë dokument janë:

- mënyra e ripërtëritjes së autorizimit për vazhdimin e shfrytëzimit të resurseve ekzistuese frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT në brezet 900 dhe 1800 MHz,

- përcaktimi i periudhës së shfrytëzimit të këtyre resurseve ekzistuese frekuencore, përfshirë edhe harmonizimin e afateve kohore, si dhe
- vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit të pagesës së njëhershme "One-Off" për këto resurse frekuencore sipas brezave.

Përveç synimeve dhe objektivave të Autoritetit për këtë fazë të procesit të hapjes së brezeve frekuencore, janë marrë për bazë edhe rekomandimet e dhëna nga kompania konsulente ndërkombëtare si në vlerësimin e resurseve frekuencore sipas brezave, ashtu edhe për mënyrat dhe periudha kohore e dhënies së resurseve frekuencore. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe marrë në konsiderim edhe komentet e operatoreve ndërlidhur me dokumentin për hapjen e brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT.

2. Korniza Rregullatore

Neni 1 (Qëllimi) i LKE-së përcakton:

"Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës."

Po ashtu neni 3, paragrafi 1) i LKE-së specifikon:

"Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike duhet të bazohet në parimet e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të burimeve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kriterëve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mos diskriminim."

Më tutje neni 10 i LKE-së definojnë kompetencat e ARKEP në kuadër të së cilave është edhe menaxhimi i resurseve të fundme: spektri i radio frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike, që në mënyrë detajuar është specifikuar në Kapitullin VII të LKE-së.

Në mënyrë të veçantë, në nenet 46 deri 51 të LKE-së është përcaktuar procedura e dhënies në shfrytëzim të resurseve të kufizuara. Neni 48 i LKE-së ka përcaktuar 3 mënyra të dhënies së resurseve të kufizuara: dhënia e drejtpërdrejtë, përmes tenderit dhe ankandit.

Në anën tjetër, dokumenti i miratuar nga QeK "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike-Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020" (*tutje referuar si - Politikat e Sektorit*) në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike ka përcaktuar objektiven si në vijim:

"Objektivi i parë është që të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik i rrjeteve të komunikimeve elektronike brez gjëra (broadband) në tërë territorin nacional dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike ("Objektivi 1 i Prioritetit 1")."

Në mënyrë specifike Politikat e Sektorit kanë përcaktuar që deri në fund të vitit 2020, rreth 100% e qytetarëve/konsumatorëve duhet të kenë qasje në shërbimet brez gjëra me shpejtësi së paku 30 Mbps.

Rregullorja nr. 22 për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave (*Ref. Nr. Prot. 054/B/13*), neni 9 (Vazhdimi i periudhës së vlefshmërisë për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave), paragrafi 9.3.1 përcakton se:

“Në rast se me Vendim të Autoritetit është caktuar që numri i autorizimeve për radio frekuenca është apo do të kufizohet, atëherë Autoriteti do të iniciojë këshillim publik në lidhje me vendimin për të vazhduar periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave;”

Ndërsa paragrafi 9.4.1. i Rregullores përcakton se:

“Të vazhdohet periudha kohore e vlefshmërisë për shfrytëzimin e radio frekuencave në rast se shfrytëzuesi i ka respektuar kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave për tre vitet e kaluara dhe ekziston njëri nga rastet e mëposhtme;

.....

9.4.1.2, Radio frekuencat për të cilat është pranuar kërkesa për vazhdim të periudhës kohore të shfrytëzimit, janë përdorur për ofrimin e komunikimeve në rrjete publike dhe ndryshimi i shfrytëzuesit të këtyre radio frekuencave mund të ngrit probleme serioze ekonomike, sociale apo aktivitete të ndërlidhura tek shfrytëzuesit e rrjetit publik telekomunikuese dhe/apo shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ky paragraf do të jetë i aplikueshëm vetëm në rast kur kushtet e tjera nuk janë ndryshuar gjatë ndërrimit të periudhës kohore për shfrytëzim të radio frekuencave;

.....”

Me Vendimin nr. 452 (*Ref. Nr. Pro. 002/B/14 dt 13.02.2014.*) ARKEP ka përcaktuar brezet frekuencore për shërbimet përkatëse, për të cilat numri i autorizimeve është i kufizuar, ku në kuadër të tyre përfshihen edhe brezet 900MHz dhe 1800 MHz.

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (*Ref. Vendim Nr. 04-V-93*) ka përcaktuar që brezet frekuencore 900 MHz (*880 -915 & 935 -960 MHz*) dhe 1800 MHz (*1710-1785 & 1805-1880 MHz*) janë alokuar për shërbimet mobile IMT për nevoja të ofrimit të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

ARKEP me Vendimin nr.1337 (*Ref. Nr.Prot.022/B/19*) ka miratuar Planet e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz:

- i. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 880-915 & 925-960 MHz, për sistemet celulare tokësore GSM, UMTS, LTE , WiMAX dhe IoT
- ii. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 1710- 1785 & 1805 - 1880 MHz për sistemet celulare taksore GSM, UMTS, LTE , WiMAX dhe IoT.

ARKEP përmes dokumenteve të hartuara dhe publikuara në WEB faqen e tij si në vijim:

- Plani për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT "(Nr. Prot. 047/B/19 Dt. 08/05/2019),
- Dokumentit "Konkluzione nga këshillimi publik i dokumentit - Plani për hapjen e brezeve" (Nr. Prot. 048/B/19 Dt. 08/05/2019),

ka informuar palët e interesit lidhur me fazat dhe afatet për hapjen e brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, **përfshirë ripërtëritjen e autorizimeve individuale** për resurset ekzistuese në brezet 900 dhe 1800 MHz në shfrytëzim nga operatorët e Telekomit të Kosovës Sh. A. dhe IPKO Telecommunications LLC, i cili pritet të realizohet në gjysmën e parë të vitit 2019 sipas metodës së drejtpërdrejtë.

Direktiva (EU) 2018/1972 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 për Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, neni 50 - Rinovimi i të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios (frekuencave) përcakton si në vijim:

1. Autoriteti rregullator do të marr një vendim për rinovimin e të drejtave për përdorimin e spektrit të frekuencave në kohën e duhur para skadimit të kohëzgjatjes së këtyre të drejtave.
2. Për marrjen e një vendimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Autoriteti rregullator do të marr në konsideratë ndër të tjera:
 - a) përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3, nenin 45 (2) të Direktivës (EU) 2018/1972 si dhe objektivat e politikave publike sipas Ligjit nacional (në rastin tonë LKE);
 - b) zbatimin e masave teknike në përputhje me Nenin 4 të Vendimit Nr. 676/2002/EC;
 - c) shqyrtimin e zbatimit të duhur të kushteve të bashkëngjitura në të drejtën në fjalë;
 - d) nevojën për të nxitur ose shmangur çdo shtrembërim (deformim) të konkurrencës në përputhje me Nenin 52 të Direktivës (EU) 2018/1972;
 - e) nevojën për përdorim më të efektiv të spektrit të frekuencave në kuptimin e evolucionit teknologjik ose të tregut;
 - f) nevojën për të shmangur ndërprerje të rënda të shërbimit.
3. Gjatë shqyrtimit të rinovimit të mundshëm të të drejtave për përdorimin e spektrit të frekuencave për të cilin numri i autorizimeve është i kufizuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, Autoriteti rregullator do të bëjë një procedurë të hapur, transparente dhe jo diskriminuese, dhe ndër të tjera do të:
 - a) t'u japë të gjitha palëve të interesuara mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre nëpërmjet një konsultimi publik në përputhje me nenin 23; dhe
 - b) do të tregoj qartë arsyet për përtëritjen e tillë të mundshme.
4. Një vendim për rinovimin e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të frekuencave (radios) mund të shoqërohet me një rishikim të tarifave si dhe të termave dhe kushteve të tjera të bashkëngjitura. Kur është e mundur (përshtatshme), Autoriteti rregullator kombëtar mund të rregullojë tarifën për të drejtat e përdorimit në përputhje me nenin 42.

Bazuar ne Kodin e Komunikimeve Elektronike të BE (Direktiva 2018/1972), neni 42, rregullatorët duhet të sigurojnë që tarifat e përcaktuara të jenë të arsyetuara objektivisht, në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e tyre të synuar dhe do të marrin parasysh objektivat e përgjithshme të Direktivës në fjalë.

Më tutje neni 42 i Kornizës së BE specifikon se lidhur me të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave, Rregullatorët do të përpiqen që të sigurojnë që tarifat e aplikueshme të vendosen në një nivel që siguron caktimin dhe përdorimin efikas të spektrit të frekuencave, duke përfshirë:

- a) përcaktimin e çmimeve për të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave duke pasur parasysh vlerën e këtyre të drejtave në përdorimin e tyre të mundshëm alternativ;
- b) duke marrë parasysh kostot që vijnë nga kushtet e lidhura me ato të drejta; dhe
- c) duke aplikuar, deri në masën e mundshme, aranzhimet e pagesave të lidhura me disponueshmërinë aktuale për përdorimin e spektrit të frekuencave.

3. Resurset frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz

Plani Kombëtar i Radio frekuencave dhe Tabelës së shpërndarjes dhe shfrytëzimit të spektrit frekuencore në brezin 9 kHz deri në 275 GHz në Kosovë ka përcaktuar se brezet frekuencore 900 dhe 1800 MHz kanë rangun e kapaciteteve frekuencore dhe destinimin e shërbimeve si në vijim:

- a. Brezi 900 MHz (880- 915 & 935- 960 MHz) me kapacitet në dispozicion prej 2x 35 MHz
- b. Brezi 1800 MHz (1710 - 1785 & 1805 - 1880 MHz) me kapacitet në dispozicion prej 2x 75 MHz.

Po ashtu Raporti 25 - CEPT (*The European Table of Frequency Allocations And Applications In The Frequency Range 8.3 kHz To 3000 GHz - October 2018*) ka përcaktuar se këto breze janë të dedikuara për shfrytëzim për shërbime GSM dhe IMT dhe harmonizuar sipas vendimeve dhe rekomandimeve Evropiane si në vijim:

GSM - ECC/REC/(05)08 ECC/REC/(08)02 ERC/DEC/(97)02
IMT - ECC/DEC/(06)13 ECC/REC/(08)02.

Nga Kapacitet e tërësishme frekuencore të planifikuar për shfrytëzim në brezin në brezin 900 MHz mbesin në dispozicion edhe 2x13,8 MHz dhe 2 x 30 MHz në brezin 1800 MHz, të cilat ARKEP do të planifikoj t'i jap në shfrytëzim në fazën e dytë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në Planin për Hapjen e Brezeve.

Kapacitet frekuencore dhe rangu i blloqeve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz që do të jenë objekt i shqyrtimit të *ripërtëritjes përmes Autorizimeve individuale* të radio frekuencave dhe vazhdimi i së drejtës së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese frekuencore për Operatorin Telekomit të Kosovës Sh. A. dhe IPKO Telecommunications LLC janë dhënë në figurën 1.




Figura 1: Kapacitetet frekuencore në shfrytëzim nga operatorët TK dhe IPKO

3.1 Kapacitetet ekzistuese frekuencore në shfrytëzim nga Operatori Telekom i Kosovës Sh. A

Operatori Telekom Kosoves ka në shfrytëzim kapacitetet frekuencore prej **2x10 MHz në brezin 900 MHz** të përcaktuar dhe të dhëna për shfrytëzim që nga data 30.07.2004 me periudhë vlefshmërie prej 15 vitesh deri më 30.07.2019 (Ref. Licenca ART-Nr. 111/04).

Resurset tjera frekuencore në brezin 1800 MHz i janë përcaktuar dhe dhënë në shfrytëzim 2x 10 MHz në vitin 2011 përmes Vendimit Nr. 135 (Ref. Nr. Prot. 054/B/11) me periudhë vlefshmërie nga 12.10.2011 deri me 30.07.2019 (sipas afatit përfundimtarë të përcaktuar në Licencës 111.04) si dhe resurset shtesë 2x15 MHz në vitin 2015 përmes Vendimit Nr. 725 (Ref.Nr. prot. 052/B/15 dt. 25.11.2015) me periudhë vlefshmërie prej 06.12.2015 deri më 30.07.2019. Të gjitha këto resurse frekuencore do të jenë i proces i Fazës së Parë për ripërtëritjen e autorizimeve individuale dhe vazhdimin e të drejtës së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese frekuencore (Tabela 1).

Tabela 1) Periudha kohore dhe Kapacitetet frekuencore të dhëna në shfrytëzim për operatorin Telekom i Kosovës Sh. A në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz për shërbime mobile në territorin e Kosovës.

Brezet Frekuencore	Kapaciteti ekzistuese frekuencore dhe periudha kohore e shfrytëzimit	Rangu i Bllqeve të përcaktuara frekuencore për Operatorin Telekom i Kosovës Sh. A	
900 MHz	2 x 10 MHz	Up link	Down Link
880- 960 MHz	Vlefshmëria e Autorizimit deri me 30/07/2019, 15 vjet > (30.07.2004 – 30.07.2019)	890.2 – 900 MHz	935.2 – 945 MHz
1800 MHz	2 x 25 MHz	Up link	Down Link
1710 – 1880 MHz	Vlefshmëria e Autorizimit deri me 30/07/2019,	1760- 1785 MHz	1855- 1879.8 MHz

3.2 Kapacitetet ekzistuese frekuencore në shfrytëzim nga IPKO Telecommunications LLC

Operatori IPKO ka në shfrytëzim kapacitetet frekuencore prej **2x10 MHz në brezin 900 MHz** të përcaktuar dhe të dhëna për shfrytëzim që nga data 06.03.2007 me periudhë vlefshmërie prej 15 vitesh deri më 06.03.2022 (Ref. Licenca e ART-se Nr. 77/07 , Dt. 06.03.2007).

Resurset tjera frekuencore shtesë me kapacitet prej 2x10 MHz në brezin 1800 MHz i janë përcaktuar dhe dhënë në shfrytëzim operatorit IPKO në vitin 2015 përmes Vendimit Nr. 726 (Ref. Nr. Prot. 054/B/15 dt. 03.12.2015) me periudhë kohore të shfrytëzimit 06.12.2015 deri me 30.07.2019 (Tabela 2).

Tabela 2) Periudha kohore dhe Kapacitet frekuencore të dhëna në shfrytëzim për operatorin IPKO Telecommunications LLC në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz për shërbime mobile në territorin e Kosovës.

Brezet Frekuencore	Kapaciteti ekzistuese frekuencore dhe periudha kohore e shfrytëzimit	Rangu i Blloqeve të përcaktuara frekuencore për Operatorin IPKO Telecommunications LLC	
900 MHz	2 x 10 MHz	Up link	Down Link
880- 960 MHz	Vlefshmëria e Autorizimit deri me 06/03/2022, 15 vjet	905 - 914.8 MHz	950.2 - 959.8 MHz
1800 MHz	2 x 20 MHz	Up link	Down Link
1710 - 1880 MHz	Autorizim i lëshuar ne vitin 2007 vlefshmëria deri me 06/03/2022 (2x 10 MHz)	1710.2 - 1720 MHz	1805.2 - 1815 MHz
	Vendim i lëshuar Vlefshmëria e Autorizimit deri me 30/07/2019 (2x 10 MHz)	1720 - 1730 MHz	1815 - 1825 MHz

Në **Shtojcën I** është bërë një përshkrim më i detajuar i resurseve frekuencore në shfrytëzim nga operatorët Telekom i Kosovës Sh. A dhe IPKO Telecommunications LLC.

4. Metodologjia vlerësimit të brezit 900 MHz dhe 1800 MHz

Me qëllim të vlerësimit të brezave frekuencore ARKEP ka angazhuar një kompani konsulente ndërkombëtare, e cila në aspektin teknik Rregullator, dhe financiar ka vlerësuar dhe rekomanduar çmimin për pagesat e njëhershme (*one-off*) të brezave frekuencore, përfshirë brezat 900 MHz dhe 1800MHz dhe ka dhënë rekomandime për mënyrat e alokimit (ndarjes) si dhe çështjet tjera teknike të shfrytëzimit të këtyre resurseve, në veçanti ripërtëritjen e autorizimeve për operatorët Telekom i Kosovës Sh. A dhe IPKO Telecommunications LLC.

Vlerësimi i këtyre dy brezeve është bërë duke u bazuar në dy metodologji krahasimore:

- metoda direkte krahasimore (direct benchmarking) dhe
- metoda ekonometrike (econometric analysis).

Metoda krahasimore është një metodologji e zakonshme, e cila përdoret nga rregullatorët dhe akterët e industrisë për vlerësimin e spektrit frekuencor. Kjo konsiderohet si metoda më

transparente për të përcaktuar vlerën e spektrit sepse përdor informacionin e vlerës së tregut, nga ankandet publike dhe, në disa raste, vlerat e mundshme të shitjes së brezeve.

Metoda direkte krahasimore ofron informacione të arsyeshme për akterët në treg për "gatishmërinë për të paguar" për spektër.

Meqenëse metoda krahasimore përfshinë përdorimin e të dhënave nga vende të ndryshme, të cilat ndodhin në kohë të ndryshme, kërkohet një kujdes i shtuar gjatë përzgjedhjes së grupit të të dhënave për të nxjerrë ato më të besueshme "si krahasime të ngjashme". Përveç kësaj, duhet të merret në konsideratë koha e ankandëve, diferencat e valutave, ndryshimet në kohëzgjatjen e licencës/autorizimit dhe tarifat vjetore të spektrit.

Qëllimi kryesor gjatë identifikimit të një grupi të dhënash të përshtatshme për analizën krahasimore është përzgjedhja e të dhënave që vijnë nga rrethana të ngjashme me ato të vlerësimeve tona të brezave dhe ku këto rrethana mund të ndikojnë në vlerën e spektrit.

Lidhur me spektrin që përdoret për shërbimet e komunikimeve mobile, faktorët kryesorë që ndikojnë në vlerën e tregut të spektrit janë si në vijim:

- *Karakteristikat e frekuencave të dhëna për shfrytëzim* - si frekuenca, teknologjitë e mbështetura dhe ekosistemi i pajisjes.
- *Kushtet e Autorizimit për frekuenca* - si kohëzgjatja e Autorizimit dhe detyrimet e mbulueshmërisë.
- *Koha e ankandëve ose dhënia e spektrit* - kjo mund të reflektojë zgjedhjen e teknologjisë në dispozicion dhe pritjet e tregut në atë kohë.
- *Treguesit ekonomik dhe të tregut* - si përmasat e tregut, gjeografia, dendësia e popullsisë, niveli i të ardhurave, niveli i konkurrencës së tregut dhe hyrësit potencialë.
- *Aspektet specifike të vlerësimit të ofertës* - kjo varet nga operatorët individual, planet e tyre të biznesit dhe se si ata synojnë që spektri të jepet për shfrytëzim.
- *Faktorët e veçantë të ankandit* - si dizajni i ankandit, çmimi rezervë, sasia (caps) e spektrit dhe niveli i konkurrencës në ankand.

Për mostrën e metodës krahasimore të drejtpërdrejtë, të dhënat para vitit 2010 kanë më pak rëndësi, pasi që këto nuk mund të reflektojnë në ndarjen sipas shërbimeve që dalin nga qasja në rritje e smart foneve, tabletëve dhe pajisje të tjera. Grupi i të dhënave për këtë metodë është marrë nga data baza e kompanisë konsulentë e angazhuar nga ARKEP.

Në vijim janë paraqitur nëngrupet të dhënave që janë marrë në konsiderim gjatë vlerësimit të brezave 900 MHz dhe 1800 MHz:

- Nëngrupi i të dhënave të ankandëve pas vitit 2010 e tutje¹;
- Nëngrupi i të dhënave për vendet evropiane (anëtarët e CEPT), pas vitit 2010 e tutje;
- Nëngrupi i të dhënave për vendet fqinje në Evropë, 2010 pas vitit 2010 e tutje; dhe
- Nëngrupi i të dhënave për vendet me ardhura të ngjashme, pas vitit 2010 e tutje.

Me qëllim për të siguruar që të dhënat referente janë shprehur në një bazë gjerësisht të krahasueshme, janë shqyrtuar një numër i procedurave gjatë të trajtimit të tyre. Ekzistojnë shumë

¹ Për brezin 900 MHz janë marrë 30 mostra, ndërsa për brezin 1800 MHz 52 mostra

faktorë që nuk mund të përshtaten, sepse të dhënat përkatëse thjesht nuk janë të disponueshme. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohet që të dhënat janë gjerësisht të krahasueshme, mund të bëhen disa përshtatje gjatë krahasimit të të dhënave, duke marrë në konsideratë diferencat në kohëzgjatjen e autorizimit, tarifave vjetore, kohën e dhënies, kursin e këmbimit, inflacionin dhe popullatën.

Hapat kryesorë në procesin e trajtimit për çdo të dhënë gjatë ndërtimit të modelit janë paraqitur si më poshtë:

- **Hapi 1:** Llogariten tarifat e ankandit dhe tarifat totale vjetore (nëse ka) për një periudhë të caktuar (për shembull 15 vjet). Kjo bëhet duke rregulluar tarifat e ankandit duke përdorur një normë të përshtatshme të skontimit dhe duke llogaritur vlerën aktuale neto (NPV) të tarifave totale vjetore gjatë kohëzgjatjes. Zakonisht përdoret Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC), e cila në rastin tonë është marrë: $WACC=11.3\%$ në përputhje me Vendimin nr.1346 (Ref. Nr.Prot.031/B/19) të ARKEP.
- **Hapi 2:** Shuma e pagesave totale (tarifat e ankandit dhe tarifat vjetore) gjatë kohëzgjatjes së autorizimit.
- **Hapi 3:** Konvertohet vlera e rregulluar e monedhës vendase në një monedhë të përbashkët (EUR) duke përdorur normat e këmbimit valutore ose PPP në kohën e ankandit.
- **Hapi 4:** Për të siguruar që të gjitha të dhënat janë në çmime reale, behet përshtatja për inflacionin duke përdorur indeksin e çmimeve të konsumit (CPI).
- **Hapi 5:** Shprehet vlera në një për MHz për kokë banori, duke e ndarë sipas shumës së spektrit të shitur dhe popullsisë të mbuluar nga autorizimet në kohën e ankandit.




Figura 2: Hapat e metodologjisë krahasimore (benchmarking)

Në figurën 2 përshkruhen hapat e detajuar të përfshirë në procesin e trajtimit të të dhënave për secilën metrikë për të siguruar që të gjitha të dhënat janë shprehur në një bazë të krahasueshme.

- **Hapi 1A:** Rregullimi i tarifës së ankandit me kohëzgjatjen e kërkuar/dëshiruar duke përdorur normën e duhur të skontimit.
- **Hapi 1B:** Llogaritja e tarifave totale vjetore mbi kohëzgjatjen e dëshiruar të referencës bazuar në normën e përshtatshme të skontimit;
- **Hapi 2:** Mbledhja e tarifës së ankandit të rregulluar për kohëzgjatjen dhe Vlerën e tanishme neto (NPV) të tarifës vjetore të për të nxjerr vlerën totale të spektrit në kohëzgjatjen e dëshiruar;
- **Hapi 3A:** Konvertimi i vlerës nga njësi valutore lokale (LCU) në EUR duke përdorur kurset e këmbimit në kohën e dhënies;
- **Hapi 3B:** Konvertimi i vlerës nga LCU në EUR PPP duke përdorur normat e PPP të Bankës Botërore;
- **Hapi 4A:** Rregullimi për inflacionin duke përdorur të dhënat kombëtare të indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) për të nxjerrë vlerën reale në EUR;
- **Hapi 4B:** Përshtatja për inflacionin duke përdorur të dhënat kombëtare të IÇK për të nxjerrë vlerën në PPP reale të euros;
- **Hapi 5A:** Ndarja e vlerës nga MHz/pop për të marrë vlerën EUR/MHz/pop;
- **Hapi 5B:** Vlera e ndarjes nga MHz/pop për të marrë vlerë EUR/MHz/pop (PPP).

Për të përcaktuar vlerën në euro për secilën pikë të të dhënave të ankandit, mund të përdoren dy kurset e këmbimit të mundshëm - kursi i këmbimit spot (hapi 4A) ose kursi i këmbimit PPP (hapi 4B) - dhe ka argumente në favor të secilit.

Normat e PPP në parim duhet të përdoren si të ardhura të operatorëve dhe kostot për inputet e blerë në vend (p.sh., vendet e punës) varen nga fuqia blerëse e monedhës vendase. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, infrastruktura dhe pajisjet mobile kanë tendencë të importohen dhe kostoja do të varet nga kursi i këmbimit në vend. Për më tepër, shumë operatorë të rrjetit mobil aktualisht operojnë në shumë vende dhe tregjet e monedhës mund të ndikojnë në ngritjen e kapitalit për të financuar ofertat e spektrit.

Kështu, rentabiliteti i operatorëve dhe gatishmëria e tyre për të paguar për spektrin do të reflektohenin përmes të dyja qasjeve: përmes PPP-së dhe spot-rregulluar. Për qartësi dhe transparencë, në këtë studim janë raportuar dy grupe vlerash (konvertuar duke përdorur PPP dhe spot), dhe rezultatet janë konsideruar së bashku me rezultatet ekonometrike në vlerësimin e vlerave për grupet që vlerësohen.

Sidoqoftë, në përputhje Kornizën Rregullatore, praktikat e vendeve tjera, si dhe rekomandimin e kompanisë konsulente, mbetet në diskrecionin e Rregullatorit (ARKEP) si institucion përgjegjës për përcaktimin e çmimit, që të përcaktohet se cilën qasje do t'a përdorë.

Analiza ekonometrike është një metodë statistikore që mund të vlerësojë raportet në mes grupeve të variablave. Një model i regresionit ekonometrik përbëhet nga një variabël e varur dhe një ose më shumë variabla të pavarura.

Modeli i përshtatet një vije të trendit më të mirë, e cila përcaktohet nga supozimi i përhapjes (ose shpërndarjes) të të dhënave, dhe zgjidhë/llogarit një ekuacion për atë vijë të trendit.

Kjo e lejon modelin të përcaktojë raportin në mes të variablës së varur dhe çdo variable shpjeguese, duke vlerësuar fuqinë dhe drejtimin e secilit raport. Këto raporte pastaj mund të përdoren për të

parashikuar vlerën e variabiles së varur për një grup të dhënë të hyrash. Kjo qasje lejon që modeli të izolohet ndikimin e faktorëve shpjegues individual në variablën e varur. Kjo lejon ndikimin e ndryshimit të një faktori të veçantë për t'u analizuar, duke mbajtur të gjithë faktorët shpjegues konstant.

Në këtë aplikacion, analiza ekonometrike mund të vlerësojë raportet ndërmjet çmimeve të spektrit të vëzhguar (për disa breza të frekuencave, jo vetëm brezit me interes) dhe faktorëve shpjegues (siç janë faktorët ekonomik ose demografik) për të parashikuar një vlerë të bazuar në faktorët specifik të spektrit të dhënë (siç janë brezi i frekuencave, pajisjet e kompatible dhe stoku i spektrit) dhe rrethanat ekonomike dhe demografike në vendin ku bëhet vlerësimi, në këtë rast Kosova. Treguesit e mundshëm të vlerës, të cilët zakonisht merren parasysh në analizat ekonometrike të vlerës së spektrit janë treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3) Metoda ekonometrike

Treguesit potencial në vlerësimin e spektrit	Variablat që do të mund të merren në konsiderim
Karakteristikat e spektrit	Brezi i frekuencave ose përhapja, kapaciteti total i ofruar, koha e ankandit, niveli i harmonizimit
Karakteristikat e Autorizimit Individual	Kohëzgjatja e Autorizimi Individual, Autorizimi në nivel nacional apo rajonal, kërkesat për mbulueshmëri
Karakteristikat e Ankandit	Raporti i ofertuesve ndaj fituesve, çmimi rezervë, formati i ankandit, kufizimet në kapacitetet frekuencore sipas brezave (ang. Spectrum caps).
Karakteristikat ekonomike dhe të tregut	GDP për kokë banori, dendësia e popullatës, penetrimi në telefoninë mobile, të ardhurat mesatare për përdorues (ARPU), numri i operatorëve të telefonisë mobile në treg, përqendrimi i tregut (HHI)

5. Mënyra e dhënies bazuar në objektivat rregullatore

Në përmbushje të objektivave për zhvillimin e rrjeteve mobile brez gjëra, ARKEP është i përkushtuar dhe i angazhuar që tërë procesi për ripërtëritjen e autorizimeve dhe dhënien e brezeve të jetë në përputhje me Kornizën Rregullatore, respektivisht parimet e rregullimit të aktiviteteve të komunikimeve elektronike siç janë: përdorimi efektiv i resurseve të kufizuara frekuencore, sigurimi i konkurrencës efektive, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencës dhe mos diskriminimit.

Marrë parasysh faktin se të dy operatorët Telekom i Kosovës Sh. A dhe IPKO Telecommunications LLC i kanë të shtrirë rrjetat e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës, mund të konkludohet se shfrytëzimi i spektrit frekuencore në kapacitet ekzistues frekuencore është duke u bërë në mënyrë efektive.

Prandaj, në përputhje me rekomandimin e kompanisë konsulente, komenteve të pranuar nga operatorët, si dhe me qëllim të ruajtjes së kontinuitetit të ofrimit të shërbimeve për përdoruesit fundorë, ruajtjes së konkurrencës, ARKEP duke marrë si bazë çmimin "One-Off" të përcaktuar si

pjesë të procesit të konsultimit publik do t'i ripërtërije autorizimet individuale për operatorët në fjalë sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke mundësuar vazhdimin e shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve frekuencore.

Për më tepër, një çmim i drejtpërdrejtë është i përshtatshëm pasi që këto dy breze frekuencore janë esenciale për operatorët Telekom i Kosovës Sh. A dhe IPKO Telecommunications LLC që të vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për përdoruesit fundorë. Në anën tjetër të dy operatorët nuk kanë breze alternative për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të tyre. Dhënia e këtyre resurseve frekuencore përmes ankandit ose tenderit (Beauty Contest) do të ndikonte në pasigurinë dhe rrezikun potencial që operatorët në fjalë mund të humbin një pjesë të spektrit të saj, e cila nga ana tjetër do të kishte një ndikim negativ në cilësinë e shërbimit. Pasiguria mund të pengojë gjithashtu investimet nga operatorët në shtrirjen e rrjeteve dhe vendosjen e shërbimeve të reja, të cilat mund të kenë një ndikim të dëmshëm në këtë sektor, duke shkaktuar probleme serioze ekonomike dhe sociale.

Zakonisht, arsyet përse rregullatorët ndonjëherë zgjedhin një ankand ose një proces hibrid (që përfshinë dhënien e drejtpërdrejtë dhe ankandin) për ripërtëritjen e autorizimeve janë:

- për të siguruar një portofol më të barabartë të spektrit ndërmjet operatorëve për të nxitur konkurrencën;
- të lehtësojë qasjen në spektër për hyrësit e rinjë ose operatorët me portofol më të vogël të spektrit;
- Promovimi i përdorimit më efikas të spektrit, duke mundësuar përshtatjen me teknologjitë e reja (refarming).

Arsyet e lartpërmendura nuk janë të aplikueshme për Kosovën, duke qenë se të dy operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO janë të vetmit operatorë në treg dhe kanë kapacitete frekuencore në shfrytëzim përafërsisht të barabartë. Për më tepër, krahas kapaciteteve që kanë në shfrytëzim nga këta operatorë, ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme të spektrit frekuencor në dispozicion në të gjitha brezet: 900 MHz dhe 1800 MHz dhe 800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz për të akomoduar hyrje të reja.

6. Përcaktimi i çmimit “One-off” për brezet 900 dhe 1800 MHz

Një hap shumë i rëndësishëm dhe parakusht për dhënien në shfrytëzim të resurseve frekuencore, përkatësisht ripërtëritjen e autorizimeve është vlerësimi i tyre dhe përcaktimi i pagesës së njehershme “One-Off” sipas brezeve në formatin **Euro/MHz/Popullsia**.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë se si ndikon përcaktimi i çmimit “One-off” në përmbushjen e objektivave rregullatore, kompania konsulente ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim (Tabela 4).

Tabela 4) Objektivat rregullatore dhe ndikimi në përcaktimin e çmimit të spektrit frekuencore

Objektiva Rregullatore	Impakti në vendimin për nivelin e çmimit	Rekomandimet e dhëna për ARKEP nga Kompania Konsulente
1 Zgjerimi i numrit të shërbimeve të reja, të cilat do të jenë në dispozicion për shfrytëzuesit fundorë	Çmimi më i ulët	Çmimi më i ulët i spektrit (çmimi rezervë) do t'i inkurajojë hyrësit e rij në treg, të cilët do të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe shërbime më të mira për konsumatorët; çmimi i lartë i spektrit mund të pengoj hyrësit e rij në treg dhe rrjedhimisht konsumatorët nuk do t'i kenë këto përfitime.
2 Mundësimi i qasjes në shërbimet brez gjëra në vendet më të largëta, si zonat rurale dhe lokacionet e izoluara	Çmimi më i ulët	Çmimi i lartë e rritë barrën e kostos së operatorëve dhe mund të dëmtoj nxitjen për investime në rrjet për shkak të zvogëlimit të rrjedhjes së parasë (cash flow); çmimi i ulët mund t'i zbusin këto rreziqe. Ky është një shqetësim i rëndësishëm në rastin e Kosovës marrë parasysh zvogëlimin e të hyrave të operatorëve.
3 Nxitja e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike	Çmimi më i ulët	Shih pikën 1
4 Sigurimi i shpejtësisë më të madhe dhe kualitetit më të mirë të shërbimeve mobile brez gjëra	Çmimi më i ulët	Tarifat më të ulëta e bëjnë spektrin më të përballueshëm që u mundëson operatorëve rritjen e kapacitetit dhe shpejtësisë.
5 Shfrytëzim efektiv dhe efikas i resurseve frekuencore si resurse të fundme	Neutral; Mund të jetë më i lartë ose ulët	Tarifat duhet të reflektojnë koston e mundësisë (Opportunity cost) të përdorimit të spektrit. Rritja e trafikut të të dhënave tregon se operatorët mobil tashmë kanë nxitjen e duhur për të shfrytëzuar spektrin në mënyrë efektive pavarësisht nivelit të çmimit.

Objektiva Rregullatore	Impakti në vendimin për nivelin e çmimit	Rekomandimet e dhëna për ARKEP nga Kompania Konsulente
6 Përmbushja e obligimeve në shfrytëzimin e resurseve frekuencore në përputhje me Kornizën Rregullatore të BE-së dhe objektivat rregullatore në vend	Neutral; Mund të jetë më i lartë ose ulët	Ngjashëm sikurse pika 5, promovimi i shfrytëzimit të spektrit në mënyrë efikase nënkupton se tarifa duhet të reflektoj koston e mundësisë. Grupi për Politikën e Radio Spektrit (RPSG) vëren se parimet e përbashkëta për çmimet që duhet të respektohen janë: (a) transparenca mbi nivelin e çmimit që do të ngarkohet për periudhën e licencimit; (b) Siguria se çmimet do të paguhen (dhe një qartësi se çka do të ndodhë nëse nuk paguhen); (c) ekzistojnë mekanizmat e përshtatshëm për të nxitur përdorimin efikas duke shmangur barrën e panevojshme ² .
7 Rritje të mëtejme të shkallës së penetrimit të shërbimeve komunikuese brez gjëra	Çmimi më i ulët	Njëjtë sikurse pikat 1,2 dhe 3 të sqaruara më lartë. Tarifat më të ulëta mund të ndihmojnë në zgjerimin e rrjetit, të inkurajojnë konkurrencën dhe zgjerojnë zgjedhjen dhe gamën e shërbimeve - të gjitha këto mund të ndihmojnë në rritjen e penetrimit të shërbimeve brez gjëra.

Me qëllim të arritjes se objektivave të referuara më lartë, si dhe marrë parasysh kriteret si në vijim:

1. Ekzistimin e kapaciteteve të mjaftueshme të spektrit frekuencore në dispozicion në të gjitha brezet;
2. Rekomandimin e kompanisë konsulente lidhur me metodologjinë e vlerësimit të brezeve dhe mënyrën e dhënies;
3. Konkluzionet në komentet e operatorëve ndaj dokumentit “Plani për hapjen e brezeve me vlerë të posaçme ekonomike”;
4. Përmbushja e obligimeve nga operatorët për shfrytëzimin e resurseve frekuencore,
5. Raporti në mes vlerës së brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz sipas vlerësimeve të kompanive ndërkombëtare;
6. Analizimin e dokumenteve tjera ndërkombëtare dhe praktikave lidhur me përcaktimin dhe dhënien në shfrytëzim të brezeve frekuencore në vendet rajonit dhe me gjerë,
7. Rënia e vazhdueshme e të hyrave të tregut të komunikimeve elektronike,
8. Krijimi i mundësive për investime në teknologjitë e reja në funksion të shtrirjes së rrjetave mobile brez gjëra.

² Radio Spectrum Policy Group. RSPG Report on Efficient Awards and Efficient Use of Spectrum. 24 February 2016.

Atëherë, ARKEP ka ardhur në përfundim se vlera e pagesës së njëhershme “One-Off” për resurset frekuencore sipas brezeve 900 dhe 1800 MHz që do të jenë objekt i ripërtëritjes së autorizimeve individuale janë dhënë në tabelën 5.

Tabela 5) Përcaktimi i çmimit të pagesës së njëhershme “One Off” në relacion me periudhën kohore për ripërtëritjen e resurseve frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz

Brezi frekuencore	Çmimi “On off” €/MHz/popullsia	Periudha kohore e Autorizimit
900 MHz	0.1410	15 vjet
1800 MHz	0.0705	15 vjet

Në përputhje me Planin për Hapjen e Brezeve dhe praktikën e vendeve ndërkombëtare për dhënien e resurseve frekuencore në brezet e dedikuara për shërbimet IMT, ARKEP synon që të jep të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore për periudha afatgjate prej 10 deri 20 vite. Mirëpo, periudha e preferuar nga ARKEP për dhënien e kapaciteteve frekuencore është 15 vite, për të cilën janë përcaktuar çmimet e dhëna në tabelën nr. 5.

Çmimi i spektrit frekuencor për periudhën 15 vjeçare llogaritet sipas formulës;

$$CS = C_{MHz/POP} \times BW_{MHz} \times P_{mbuluar}$$

CS- Çmimi i spektrit; $C_{MHz/POP}$ - Vlera e spektrit prej 1 MHz për popullësi; $P_{mbuluar}$ - numri i popullësisë së vendit (sipas regjistrimit të fundit/të dhënave zyrtare nga ASK numri i popullësisë është 1,795,666³)

Llogaritja e vlerës së spektrit frekuencor me kohëzgjatje të ndryshme nga periudha 15 vjeçare, pra për N vite kullohet sipas formulës:

$$Vlera\ e\ Spektrit_N = \frac{Vlera\ e\ Spektrit\ 15vjet}{\sum_{t=0}^{14} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^t} * \sum_{t=0}^{N-1} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^t$$

Apo e shprehur në muaj M;

$$Vlera\ e\ Spektrit_M = \frac{Vlera\ e\ Spektrit\ 15vjet}{\sum_{t=0}^{179} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^{t/12}} * \sum_{t=0}^{M-1} \left(\frac{1}{1+WACC}\right)^{t/12}$$

³ <http://ask.rks-gov.net/media/4892/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2018.pdf>

7. Qëndrimet e ARKEP-it në procesin e ripërtëritjes së Autorizimeve individuale të resurseve frekuencore ne brezet 900 MHz dhe 1800 MHz ne shfrytëzim nga Operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO

- a) Kapacitetet frekuencore që do të jenë objekt i ripërtëritjes së autorizimeve janë specifikuar në tabelat 1 dhe 2, vlefshmëria e të cilave do të skadojë më 30 Korrik 2019, përkatësisht 6 mars 2022.
- b) Pavarësisht qëndrimit të specifikuar në pikën 1, kapacitetet frekuencore që skadojnë më 6 mars 2022 me kërkesë të operatorit mund të shqyrtohen në një periudhë të mëvonshme, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të autorizimit.
- c) ARKEP me këtë proces të ripërtëritjes së autorizimeve planifikon që periudha e vlefshmërisë së shfrytëzimit të këtyre resurseve frekuencore do të jetë 15 vite nga data e skadimit. Megjithatë, operatorët kanë të drejtë që të aplikojnë për periudha të tjera kohore brenda intervalit: 10 deri 20 vite. Me këtë rast përlllogaritja e çmimit do të behet sipas formulës të specifikuar në pikën 6.
- d) ARKEP i inkurajon operatorët që të harmonizojnë afatet kohore të përfundimit të vlefshmërisë së autorizimeve.
- e) Në përputhje me rekomandimet e CEPT/ECC dhe direktivat evropiane, ARKEP gjatë procesit të ripërtëritjes së autorizimeve në bashkëpunim me operatorët do të shqyrtojë mundësinë e korigjimit të skajeve të blloqeve frekuencore (frequency adjustments) për të dy brezet: 900 MHz dhe 1800MHz në përputhje me Planet e përdorimit të miratuar me Vendimin nr.1337 (Ref. Nr.Prot.022/B/19).
- f) Në përputhje me kërkesat e LKE -së dhe Rregullores nr.22, operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO Telecommunications duhet të dërgojnë në ARKEP, kërkesën së bashku me aplikacionin për vazhdimin e periudhës së vlefshmërisë për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave, duke përfshirë ndër të tjera: periudhën e vlefshmërisë, rangun bllokut dhe kapacitetet ekzistuese frekuencore për secilin brez (900 dhe 1800 MHz).

Kërkesa duhet të dërgohet deri më datë 15 Korrik 2019.

- g) Në procesin e ripërtëritjes së autorizimeve ARKEP nuk do të vendosë obligime shtesë për mbulueshmëri, megjithatë operatorët duhet të sigurojnë se nuk do të ketë zvogëlim të mbulueshmërisë për territor dhe popullësi, si dhe degradim të kualitetit të shërbimeve. Pavarësisht kësaj, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapësirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët ARKEP në çdo kohë mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve.
- h) Sa i përket pagesës në këste, ARKEP në këtë proces lejon mundësinë e pagesës me këste vjetore të çmimit "one-off" sipas normës së interesit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës, duke aplikuar normën e interesit në baza vjetore.

Operatorët përveç mundësisë së pagesës së përnjëhershme “one off”, kanë mundësi të përzgjedhin një nga opsionet e ndarjes në këste si më poshtë, për të cilin do të paguajnë normë interesi respektiv të dhënë në këtë tabelë në kolonën mesatarja e baraspeshuar.

Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste	Norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)
Ndarja në kiste 2 Vjeçare	1.24507
Ndarja në kiste 3 vjeçare	1.27999
Ndarja në kiste 5 vjeçare	2.44155
Ndarja në kiste 7 vjeçare	3.51486
Ndarja në kiste 10 vjeçare	5.28238

Ndërsa përlogaritja e pagesës vjetore llogaritet sipas formulës në vijim.

Nëse autorizimi është për D vite dhe pagesa “one-off” do të bëhet sipas viteve për kohezgjatjen e autorizimit (D vite), atëherë pagesa vjetore për vitin e parë llogaritet:

$$P1 = \frac{Vlera\ e\ Brezit_D}{D}$$

Ndërsa pagesa në keestet tjera (D-1 këste të barabarta) llogaritet si në vijim:

$$Pagesa\ Vjetore = (Vlera\ e\ Brezit_D - P1) \times \frac{i}{1 - (1 + i)^{1-D}}$$

Ku i- është norma e interesit/kuponit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës e shprehur për D-1 vite

Në rast të përcaktimit për pagesën me këste vjetore, me qëllim të sigurimit të realizimit të pagesës, ARKEP do të aplikoj mekanizmat adekuat të specifikuar në autorizime, duke përfshirë pasojat për operatorët për mos pagesë eventuale.

- i) Pagesa “one-off” ose kësti i parë, duhet të realizohet brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të fatures.

- j) Në rast se operatori nuk e përmbush obligimin për pagesë, atëherë ARKEP do të veproj si në vijim:
- Për cdo vonesë në pagesa do të aplikohet masa ndëshkimore prej 8% për shumën e faturuar;
 - Në qoftë se për dy vite me radhë operatorët nuk kryejn pagesat e përcaktuara me Vendim, ARKEP nëpërmjet procedurës së përmbarimit do të ekzekutoj tërë shumën e mbetur duke përfshirë normën e aplikuar.
- k) Operatorët kanë të drejtë që pas një periudhe të caktuar kohore pagesa e vlerës së mbetur të bëhet në konceptin "One off fee", dhe me këtë rast nuk do të aplikohet më tutje norma e interesit. Njoftimi nga ana e operatorit për mundësinë e pagesës për pjesën e mbetur duhet të bëhet së paku 3 (tre) muaj më herët.

SHTOJCA I. Kapacitetet ekzistuese frekuencore me vlere te posaçme ekonomike ne brezet 900 dhe 1800 MHz ne shfrytëzim nga operatorët Telekom i Kosovës Sh. A dhe IPKO Telecommunicaions LLC dhe referencat e akteve, përmes të cilave janë alokuar këto kapacitete

Brezet Frekuencore 900 dhe 1800 MHz, rangi dhe kapacitetet e disponueshme ne keto breze per sherbime IMT	Operatorët ekzistues te Autorizuar per ofrimin e sherbimeve mobile ne nivel vendi	Kapacitetet e dhëna frekuencore në shfrytëzim për shërbime IMT në Kosovë nga Operatorët ekzistues dhe periudha e vlefshmërisë se Autorizimeve	Dokumentet ARKEP (ART) per te drejtën e shfrytëzimit te resurseve frekuencore ne brezet 900 dhe 1800 MHz	Rangu i resurseve frekuencor ne shfrytezim nga Operatorët ekzistues ne brezt 900 dhe 1800 MHz	
900 MHz 880 - 915 & 925 - 960 MHz 2 x 35 MHz	Telekom i Kosoves Sh.A	2 x 10 MHz deri me 30.07.2019	ART-Licence Nr. 111/04 Dt. 30.07.2004 Nr.prot. 01-6454/04 Vendimi 400, Shtojce B Nr.prot. 031/B/13, dt. 04.10.2013	890.2 - 900. & 935.2 - 945 MHz	
	IPKO Telecommunicaions LLC	2 x 10 MHz deri me 06 Mars 2022	ART-Licence Nr. 77/07 Dt. 06.03.2007	905 - 914.8 & 950.0 - 959.8 MHz	
1800 MHz 1710 - 1785 & 1805 - 1880 MHz 2 x 75 MHz	Telekomi i Kosovës Sh. A	2 x 25 MHz	2 x 10 MHz deri me 30.07.2019	ARKEP-Vendim Nr. 702 Nr.prot. 043/B/15, Dt. 21.11.2015	1775 - 1784.8 & 1870 - 1879.8 MHz
			2 x 15 MHz - deri me 30.07.2019	ARKEP -Vendim Nr. 725 Nr.prot. 052/B/15, Dt. 25.11.2015	1760 - 1775 & 1855 - 1870 MHz
	IPKO Telecommunicaions LLC	2 x 20 MHz	2 x 10 MHz - deri me 06.03 2022	ART-Licence Nr. 77/07 Dt. 06.03.2007	1710.2 - 1720.2 & 1805.2 - 1815.2 MHz
			2 x 10 MHz - deri me 30.07.2019	ARKEP - Vendim Nr. 726 Nr.prot. 054/B/15, Dt. 03.12.2015	1720 - 1730 & 1815 - 1825 MHz